

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TE RENDA – kryetari i trupit Gjykues - Gjyqtari Burim Ademi dhe Bashkëpunëtorin profesional Gëzim Ademi, duke vendosur ne çështjen penale ndaj te pandehurit [REDAKTUAR] rr. [REDAKTUAR] put” [REDAKTUAR], Vranje për shkak te veprës penale Dhënia e ryshfetit nga neni 429 par. 1 te KPRK-se, i akuzuar sipas aktakuzës se Prokurorisë Themelore ne Mitrovice-departamenti i krimeve te renda PP-I.nr.23/2017, te dt.08.03.2017, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimitor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me dt.08.03.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e prokurorisë Themelore ne Mitrovice-departamenti i krimeve te renda PP-I.nr.23/2017, e datës 08.03.2017, dhe gjykata e jepe këtë:

U R D H Ë R N D Ë S H K I M O R

I pandehuri [REDAKTUAR] i lindur me dt. [REDAKTUAR] ne [REDAKTUAR], ku edhe tani jeton, rr. [REDAKTUAR] put”nr. [REDAKTUAR], serb shtetas i Serbisë, me profesion shofer, i martuar, ka kryer shkollën teknike te komunikacionit rrugore, i gjendjes se mesme ekonomike, i pa dënuar me pare.

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE: Me dt. 08.03.2017, rreth orës 02:05 min. ne rrugën magjistrale [REDAKTUAR] saktësisht ne [REDAKTUAR] i ofron personit zyrtar- [REDAKTUAR], para me qellim qe te mos veproj ne pajtim me detyrën e tij zyrtare, ne atë mënyre qe i pandehuri ndalohet nga njësia e patrullës se trafikut duke drejtuar kamionin e makrës “ [REDAKTUAR] ” ngjyrës se bardhe me targa [REDAKTUAR], prone e firmës “ [REDAKTUAR] ” e kur i kërkohet dokumentacioni përkatës, ne mungesë te certifikatës mjekësore i ofron zyrtarit kartëmonedhën prej 5Euro me numër serik [REDAKTUAR] për kafe e mos ti shqiptoj gjobën.

Me këtë ka kryer vepër penale Dhënia e ryshfetit nga neni 429 par. 1 KPRK-së.

Andaj gjykata ne baze te kësaj dispozite ligjore e lidhur me neni 4,7, 17,41,46, dhe 73 te KPRK-se, dhe nenet 450, 453 par.1, 463, 496 dhe 365 te KPP-se, i shqipton:

D E N I M M E G J O B Ë

Ne shume prej 180 €/njëqind e tetëdhjetë euro/ te cilin dënim është i obliguar ta paguaj menjëherë pa plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi me gjobe nuk munde te realizohet, ne baze te neni 46 te KPRK-se, i njëjti te pandehurit do t’ju zëvendësohet me dënim me burg, duke llogaritur çdo 20 /njëzet/ euro me 1 /një/ dite burgim.

Gjykata ne mbështetje te nenit 62 par 1 e 2 nen par 6. Te dënuarit i shqipton Dënim Plotësues: Konfiskimi i kartëmonedhës ne lartësi prej 5 pese euro me nr serik [REDAKTUAR]. Kjo kartëmonedhë do ti dorëzohet agjencinë për administrimin e pasurisë se konfiskuar dhe sekuestruar pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri ti paguaj shpenzimeve e procedurës penale ne shumen prej 20 €, te gjitha këto është i obliguar qe ti paguaj menjëherë pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Kërkese pasurore juridike nuk kishte.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë-departamenti i krimeve te renda ka paraqitur aktakuzën e saj PP-I.nr.23/2017, te dt.08.03.2017, kundër te akuzuarit [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] rr. [REDAKTUAR] për shkak te veprës penale Dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.1 KPRK-ës dhe nga gjykata ka kërkuar qe kundër te akuzuarit te jepe urdhër ndëshkimor-shqiptimin e dënimit me gjobe pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësore.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak te aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënien e urdhrin ndëshkimore ne kuptim te nenit 495 te KPPK-së.

Gjykata vlerësoj se ne shkresat e lendes ekzistojnë prova te besueshme për dhënien e urdhrin ndëshkimore te cilat e vërtetojnë faktin se i pandehuri e ka kryer veprën penale ne fjalë si: shkresat e policisë sipas numrit te rasti 2017-KE-78 te datës 08.03.2017, vërtetimi mbi konfiskimin e sendit, fletëparaqitja per kundërvajtje ne trafik me numër [REDAKTUAR] te datës 08.03.2017, fletudhëtimin nr [REDAKTUAR] si dhe vlerësimin ne kartëmonedhën prej 5 Euro qe gjendet ne shkresat e lendes, andaj gjykata te njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Gjykata duke u bazuar ne këto prova te besueshme vërtetoi se ne veprimet e te akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.1 te KPRK-së.

Me rastin e marrjes se vendimit mbi dënimin ndaj te pandehurit gjykata i pati parasysh te gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese te parapara ne nenin 73 te KPRK-së, e ne rastin konkret për te njëjtin rrethane lehtësuese gjeti faktin se i njëjti ne deklaratën e dhëne ne polici i njëjti e ka pohuar se janë ka ofruar paratë ne shume prej 5 euro te pine kafe, i njëjti për here te pare ka ra ndesh me ligjin, ndërsa rrethane renduese gjeti faktin se vepra penale te kësaj natyre janë ne rritje e sipër, andaj duke u bazuar ne rrethanat rëndues dhe lehtësuese te cekura si me larte gjykata te akuzuarit i shqiptoj dënim si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, duke pritur me te drejte se me dënimin e shqiptuar do te arrihet qëllimi i dënimit i parapare sipas nenit 41 te KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet gjyqësore dhe paushallin gjyqësor gjykata e mori duke u bazuar ne nenet 450 dhe 453 par. 1 te KPRK-së.

Kërkese pasurore juridike nuk kishte.

Nga se u tha me larte u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE

Departamenti i Krimeve te Renda

P.nr.31/2017 me date 08.03.2017

Procesmbajtësi:

Gëzim Ademi



Gjyqtari

Burim Ademi



KESHILLA JURIDIKE: Kundër ketij aktgjykimi mund te ushtrohet kundërshtim ne afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes me shkrim se ketij aktgjykimi. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate me shkrim apo me gojë ne procesverbal te kësaj gjykate.

Republika e Kosovës



Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPËSË E VËRTETËSON
ТАЧНОСТ ОТПРАВКА ПОТВЕРДУЈЕ

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik

